



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
Ministria e Shëndetësisë / Ministry of Health
Agjencia Kosovare për Produktet dhe Pajisjet Medicinale / Agency for Medicines and Medical Devices

Nr. i Org. / Org. Unit: 01
N. Prot. / Prot. No.: 2248/2
Nr. i faqeve / Broj stranica: 04
Data / Datum: 18.07.2024

Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravlja / Ministry of Health

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale / Kosovska Agencija za
Medicinske Proizvoda / Kosovo Medicines Agency

DATA/E	18.07.2024
NGA/FROM	Labinot Mustafa - Zyrtarë i Pranimit dhe Logjistikës Jehona Muli Gashi – Zyrtare e Pasurisë Leonora Haziraj – Ass. Arkivë
PËRMES/PREKO/THROUGH	
PËR/ZA/TO	Sejdë Tolaj – Zv. Kryeshefit Ekzekutiv –AKPPM
Cc./Cc/cc	Sevdije Rushiti-U.D Drejtor i DABF-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgaditja e specifikave për marrjen e objektit me qera në bazë të vendimit me nr. Prot. 2248

Të Nderuar/a

Ne si komision i emëruar në bazë të vendimit me nr. Protokoli 2248 të datës 11.07.2024 i kemi përgaditur specifikat që kërkohen për marrjen e objektit me qera.

Dokumentacioni i bashkangjiturë:

- ✓ Njoftimi për thirrje publike.

Me respekt



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Governmentf

Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health
Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale / Kosovska Agenacija za Medicinske
Proizvoda / Kosovo Medicines Agency

Njoftim për thirrje publike

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe të besueshmërisë në procesin e njoftimit për thirrje publike, për marrje me qira të objektit dhe garantimin e zbatimit të parimit të konkurrueshmërisë dhe interesave të qytetarëve dhe subjekteve juridike, si dhe me qëllim të akomodimit të stafit të saj, AKPPM bën njoftim për marrje me qira të një objekti, për vendosjen e stafit. Andaj, bazuar në këtë bën thirrje publike për ofertë:

Njofton të gjitha subjektet e interesuara, që përmes aplikimit të tyre të paraqesin ofertat për dhënie me qira të objektit me qëllim të lidhjes së kontratës për kohë të caktuar prej dy (2) vite (me mundësi vazhdimi), mes AKPPM-së dhe kontraktuesit (qiradhënësit). Pagesa për objekt do të jetë pagesë mujore.

Objekti duhet të plotësoj kriteret bazë, sipas specifikimeve të mëposhtme dhe të ketë mundësi ndërhyrje për ndarje të hapësirave, zyre të punës bazuar në marrëveshje:

Kriteret që duhet të plotësohen për shprehje të interesit për dhënie me qira të objektit, janë si në vijim:

1. Objekti duhet të ketë hapësira për zyre dhe shërbime prej 1000 deri 1200 metër katror;
 - a. Objekti duhet të posedoj zyre të mjaftueshme për sistemimin e 50 punëtorëve.
2. Të jetë i përshtatshëm për mundësi ndërhyrje nga qiradhënësi për ambient për punë, i ndarë nga veprimtari të tjera (kati);
3. Objekti duhet të jetë modern dhe të ndodhet në një pozitë shumë të favorshme,
4. Vërtetimi tatimorë që dëshmon se nuk ka obligime tatimore;
5. Të ketë leje ndërtimi dhe përdorimi (Certifikatën e përdorimit sipas Ligjit për Ndërtimin);

6. Vendndodhja në Prishtinë - Jo më larg se tri (3) kilometra nga qendra, pikë referimi Katedraleja e qytetit;
7. Të ketë vend parkingje për vetura, tridhjetë deri katërdhjetë (30 - 40);
8. Të ketë qasje të lehtë në rrugë;
9. Ngrohje, rrymë, rrymë alternative/gjenerator, ujë, ventilim, ngrohje nga ngrohtorja e qytetit përparësi, nëse plotësohen edhe kushtet të tjera;
10. Infrastrukturë për qasje në internet, ndriçim natyror;
11. Në rast që objekti ka dy (2) etazhe të ketë së paku dy (2) tualete për femra dhe dy (2) për meshkuj në secilën etazh/kate, nëse hapësira shtrihet vetëm në një etazh/kate të ketë tri (3) tualete për femra dhe tri (3) tualete për meshkuj me nga tre lavaman duarsh;
12. Hyrja kryesore të jetë së paku prej 1.5m deri në 2.5m gjerësia;
13. Lartësia e objektit/katit minimum 2,6 m;
14. Qasje për persona me nevoja të veçanta, hyrje të lehtë/ashensor;
15. Objekti të jetë në zonë e cila ka qasje në linjën e Trafikut Urban.

Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të dorëzohet për aplikim:

1. Leja e ndërtimit me dokumentacionin përcjellës (certifikatë e pronësisë, kopje plani, projekti, skica të objektit dhe hapësirës së jashtme, foto);
2. Deklaratë nën betim se objekti nuk është në kontest gjyqësor dhe se nuk ka çfarëdo mase të sigurisë nga gjykatat apo organet e tjera publike;
3. Oferta financiare, çmimi për metër katror dhe shuma totale e m², duke përfshirë të gjitha tatimet dhe obligimet e tjera.
4. Vërtetim/dëshmi të pagesës së tatimeve dhe obligimeve financiare, duke përfshirë komunalitë.

Periudha e aplikimit:

Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në web-faqen e Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM), <https://akppm.rks-gov.net/>.

Të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë sipas thirrjes publike, duhet të shprehin interesimin e tyre, duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin në kopje fizike me ofertat e tyre në **Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM)/ Kati përdhes zyre Nr. 04, Rrethi i Spitalit "QKUK", Prishtinë, për çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në orën 12:00, si dhe nga ora 13:30 deri 15:00.**

Pas mbylljes së afatit të aplikimit, AKPPM do të bëjë përzgjedhjen e ofertës më të përshtatshme, duke marrë në konsideratë distancën nga qendra e qytetit, përshtatshmërinë e objektit për adaptimin e nevojave të stafit dhe eficiencën në ngrohje dhe qasjen sa më të lehtë për qytetarët dhe stafin.

Gjatë procesit të përzgjedhjes së objektit, AKPPM do të vizitojë objektet të cilat i plotësojnë kriteret.

Të drejtë aplikimi kanë personat fizik dhe juridik. Në rast të aplikimit të personave fizik/juridik nëpërmjet ndërmjetësuesve, të paraqitet autorizim noterial nga ana e personi fizik apo përfaqësuesi i personit juridik.

Nënshkrimi i kontratës do të bëhet nga personi fizik apo përfaqësuesi i personit juridik.

Aplikacionet që dorëzohen në mënyrë fizike, duhet të jenë të mbyllura në zarf, të jenë të vulosura me vulë në pjesën ku mbyllet zarfi, në të cilin shkruhet:

- *Emri dhe Mbiemri ;*
- *Data e aplikimit;*
- *Kontaktet.*

Thirrja do të jetë e hapur nga data 18.07.2024 deri me datë 31.07.2024, në orën 15:00.

Për informata shtesë, kontaktoni:

Zyrtarë i Pranimit dhe Logjistikës: *Labinot Mustafa*

Tel: 03820024238 & 038512126

E-mail: labinot.mustafa@rks-gov.net

Aplikimet pas këtij afati nuk pranohen.